

## Mbreti Zog dhe Mbreti Leka irritojnë shtabet...

Nga Murat Basha

E vërteta nuk mund të dhunohet më

Shkrimi i Kastriot Myftaraj, botuar tek gazeta “Tema” me titullin “Leka Zogu karikatura e Simeonit II; forca e tretë si kolonë e pestë” - është shembulli më tipik i keqpërdorimit të fakteve dhe realiteteve historike nëpërmjet spekulimit me të vërtetat, nxjerrjes së konkluzioneve me anë të përdhunimit të logjikës formale dhe duke shpalosur gjysëm të vërteta e pasaktësi të qëllimshme.

Spekulimi i parë i këtij shkrimi nis me servirjen e përfundimit se Partia Popullore e themeluar në vitet '20 të shekullit të kaluar kishte “orientim bolshevik”, pa e mbështetur atë me argumenta programorë dhe fakte. Që këtej, autorët vijojnë me spekulimin tjetër, sipas të cilit meqenëse Ahmet Zogu asokohe aderoi në këtë parti, atëherë duhet të pranohet edhe konkluzioni pasues se ai “hyri në politikën shqiptare në radhët e së majtës” dhe më pas pranoi të përdorej nga krerët e majtë të kësaj partie “për të përçarë të djathtën (!?)”. Më poshtë autorët pranojnë se Zogu u largua nga kjo parti “duke dalë si forcë e tretë mes dy partive kryesore, asaj Popullore dhe asaj Përparimtare”.

Burimet e njohura historike vërtetojnë se shkak i largimit të Zogut nga Partia Popullore është braktisja e angazhimeve programore nga krerët e kësaj partie që, me kohë, pasi u shuguruan në Moskë, adaptuan praktika të dhunshme për arritjen e qëllimeve politike.

EkspONENTI më tipik i bartjes së pikëpamjeve terroristo-anarkiste ishte Avni Rustemi, i cili kudo fliste dhe bënte plane për eliminime fizike të kundërshtarëve. Gjithashtu, prova më e mirë e praktikave dhe frymës totalitariste të tipit anarko-marksist e komunist të Rustemit me shokë, ishin ngjarjet që i prinë atentatit kundër kryeministrit Zog në parlament dhe ato që pasuan “Revolucionin” e Qershorit.

Peza kurorëzoi nacionalistët

Më tej, pasi lëshojnë disa të vërteta të njohura, me anë të një kërcimi pindarik autorët kalojnë tek një spekulim me logjikën më elementare, duke përdorur supozimin “me sa duket”, të pambështetur me fakte, për të “argumentuar” aderimin e Abaz Kupit me Frontin Nacional-çlirimtar, dhe duke anashkaluar qëllimisht faktin se Konferencën e Pezës e organizuan dhe drejtuan zogistët dhe nacionalistët e tjerë, ndërsa komunistët thjesht u pranuan si aleatë në luftën kundër fashizmit pushtues. Dhe kjo sepse Mbreti Zog, zyrtarisht, i shpalli luftë Fashizmit, pasi më 6 Prill 1939 hodhi poshtë ultimatumin e turpshëm, duke kërkuar njëkohësisht mbështetje tek Fuqitë e Medha dhe Lidhja e Kombeve. Zogistët e derdhën gjakun më 6-7-8 Prill. Ku ishin komunistët dhe të tjerët???

Në vijim, pasi përdorin faktin e vërtetë se Enver Hoxha dhe Koçi Xoxe ishin agjentë të shërbimeve sekrete të Mbretit Zog, me supozime, tashmë të vetligjëruara, autorët lëshojnë pohimin e pambështetur se “Në rast se krerët komunistë nuk e mbanin premtimin (se komunistët do ta mbështesnin kthimin e Zogut në Shqipëri pas lufte), zogistët do t'i demaskonin”.

Këto pseudoargumenta nuk qëndrojnë sepse, së pari, komunistët në shtator 1942 nuk ishin kurrfarë faktori ushtarak e aq më tepër politik, për ta detyruar Mbretin Zog për të bashkëpunuar me shpresë për të ardhmen e pasluftës. Së dyti, Mbreti Zog kurrë nuk i ka përdorur argumentat “agjenturorë” për synime politike, sepse Mbreti i la arkivat sekrete në Shqipëri, pra nuk synonte t'i përdorte. Edhe pas LDB, Ai kurrë nuk lëshoi asnjë akuzë për agjentët komunistë, ndonëse i urrente ata, si agjentë të fashistëve dhe si agjentë të serbëve e rusëve.

Supozimet shtrembërojnë historinë

Më poshtë autorët sërish vazhdojnë të përdorin togfjalëshin supozues “me sa duket” në pohimin absurd “me sa duket zogistët e kërkonin vendin e kryetarit të Këshillit Nac-Çl. për

Ahmet Zogun(!!!)", për të vazhduar spekulimin me të njejtin "konkluzion", që vazhdon pas togfjalëshit "Pas të gjitha gjasave...". Sa për sqarim, jam i detyruar t'u rikujtoj autorëve se Mbreti Zog, as gjatë LDB e as pas saj, nuk pranoi kurrë ndonjë post tjetër, përpos atij legjitim si Mbret i Shqiptarëve.

Nëse Mbreti do kish synuar postin e kryetarit të Frontit Nac-Çl., nuk do t'u kish kërkuar anglezëve ta ndihmonin për të zbarkuar në Çamëri, për të hyrë në Shqipëri e drejtuar luftën. Pse do ta vinte kokën në rrezik, nëse do ta kish postin të sigurtë me telekomandë nga Londra!!!

Pas këtij spekulimi, autorët kapërcejnë tek konkluzioni që synojnë që në fillim, e që përbën lajtmotivin e të gjithë shkrimit - tek "aleanca" mes Mbretit Zog me Enver Hoxhën (!!!), për të shpikur pastaj "konvenimin e iluzioneve të zogistëve me skemat e komunistëve jugosllavë...". Fryma nacionaliste e zogistëve, e jetësuar në titullin Mbret i Shqiptarëve, është vija e demarkacionit midis tyre e sllavëve, çka hesh poshtë aluzion e autorëve se zogistët mund ta pranonin konvenimin e iluzioneve të tyre me komunistët sllavë.

Më tej, pretendimi i autorëve se gjoja në Pezë "komunistët me anë të bashkëpunimit me zogistët donin të krijonin idenë se nuk luftonin për pushtet", nuk është aspak i vërtetë dhe bindës, pasi, së pari, zogistët nuk ishin aq naivë sa ta hanin këtë përrallë. Së dyti, vetë krijimi i një partie prej tyre (asaj komuniste), nuk bëhej për të gatuar paça, por për të luftuar për pushtet. Së treti, vetë nocioni "këshill", (që u përdor për herë të parë në Pezë), nënkupton përfaqësi dhe institucion pushteti. Dhe së katërti, Mbreti Zog nuk shqetësohej nga krijimi i partive që synonin pushtet qeverisës, sepse funksioni i Tij kushtetues ishte mbi partitë dhe nënkuptonte qëndrimin jashtë tyre dhe ndikimeve politike.

Atëkohë, (në shtator 1942), komunistët shqiptarë as që guxonin ta çonin nëpër mend ndryshimin e formës së regjimit për një republikë. Ata thjesht synonin pushtet, dhe këtë Mbreti Zog dhe zogistët e kuptonin mjaft mirë, por zhvillimet e deriatëhershme nuk linin asnjë shkas për shqetësime të kësaj natyre (pra për ndryshimin e formës mbretërore të regjimit politik, pas luftës).

Edhe krijimi i Partisë "Balli Kombëtar" në nëntor të vitit 1942, ishte brenda optikës politike të Mbretit Zog për parlamentarizmin, konsolidimi i të cilit ka qenë synimi politik permanent i Tij, dhe për këtë dëshmon jeta parlamentare e viteve 1924-1939.

Ndërsa përsa i përket hapësirave për pluralizmin, Mbreti i kufizoi ato pas implikimeve agjenturore të lidhshimit politik dhe rebelimeve subversive antikushtetuese që shteti shqiptar u detyrua të përballonte gjatë viteve 1924-1939.

Diversiteti programor midis monarkistëve legalistë nga njëra anë dhe komunistëve e ballistëve nga ana tjetër, nuk vinte në dyshim formën e regjimit, madje pikërisht për këtë arsye Mbreti Zog nuk e pa të nevojshëm rithemelimin e Partisë së Legalitetit deri në tetor të vitit 1943.

Mbreti e rithemeloj OKLL (PLL) vetëm kur u bë e qartë se komunistët hynë në rrugën pa kthim të luftës civile, sipas skemave serbo-sllave, për të marrë, (të vetëm), pushtetin dhe për ta përdorur në shërbim të padronëve antishqiptarë. Në këto rrethana, Mbreti Zog u detyrua të iniciojë krijimin e një formacioni politiko-ushtarak, për vetmbrojtje dhe barazpeshë në zhvillimet me tendencë përkeqësimi. Por gjithmonë Ai synoi dhe punoi për shmangien e luftës vëllavrasëse, dhe këtë e dëshmon veprimtaria e Kupit dhe e OKLL.

Mbreti u përpoq për intensifikimin e luftës çlirimtare, çka e vërtetonte veprimtaria e Tij në Angli, ku bashkëpunoi intensivisht me aleatët.

Mbreti dhe Kupi u përpoqën ta shmangin ngritjen e parakohshme të problemeve të pushtetit, sepse kjo do ta pengonte intensifikimin e luftës çlirimtare dhe do ta shndërronte atë thjesht në luftë civile. Por 6 muaj më vonë, komunistët bënë Përmetin.

Edhe Regjenca ishte vazhdimësi e formës monarkiste të regjimit në Shqipëri, konsakruar që më 1913 nga Konferenca e Londrës. Por komunistët, në Kongresin e Përmetit, e hodhën poshtë monarkinë, për ta zëvendësuar atë me "monarkinë" e mbretit komunist të Ballkanit,

J.B.Titos, domenit të të cilit deri më 1948 u përpoqën t'i bashkëngjitnin edhe "provincën" e Shqipërisë londineze.

Mukja, diskreditoi komunistët

Autorët gabojnë qëllimisht edhe në shtrimin e realiteteve politike që paraprinë dhe shoqëruan Konferencën e Mukjes, çka e vërtetojnë me pseudoargumentin se "Abaz Kupi shkoi në Mukje si lejtnant i Enver Hoxhës". Provë kundër këtij pohimi absurd ishte dhe mbetet fakti i dominimit të Mukjes nga nacionalistët jokomunistë, qoftë numerikisht, qoftë edhe si frymë. Rezoluta përfundimtare dëshmon se në Mukje diktuan dhe u miratuan qëndrimet dhe tezat politike të nacionalistëve, çka i detyroi Hoxhën (bashkë me serbët që qëndronin pas tij), që ta pranonte "kapitullimin" e PKSHP dhe përfaqësuesve të saj përballë nacionalistëve, gjë që determinoi edhe denoncimin prej komunistëve, e më pas zhbërjen e marrëveshjes së arritur. Nëse Kupi do të ishte "lejtnant i Hoxhës", ai do të vazhdonte bashkëpunimin i detyruar prej tij, dhe nuk do të reagoonte aq ashpër sikundër reagoi ndaj pabesisë së komunistëve, duke deklaruar paskëta largimin nga forumet drejtuese të Frontit Nac-Çl. Por qëndrimi i tij pacifist ndaj kundërshtarëve të ndërkryer komunistë edhe pas Mukjes, lidhej me optikën politike dhe bonsensin e Mbretit Zog, i cili gjithmonë kish qenë xheneroz me kundërshtarët e tij gjakësorë. Koha ka vërtetuar se Mbreti Zog gjithmonë është përpjekur t'i largonte ata nga rruga e kimit dhe e tradhtisë në shërbim të armiqve historikë, duke përdorur stimulimin financiar dhe amnistitë e pafundme, ndërkohë që edhe mund t'i zhdukte fizikisht. Aq më tepër që, asokohe, gjatë mbretërimit të Tij, në Evropë askush nuk pyeste për "koka të prera", pasi qeveritë dhe politikanët e kontinentit plakë nuk kishin ndërmend të tharthonin trutë me gjyotinat dhe kasaphanat e Hitlerit, apo Frankos gjatë luftës civile në Spanjë, e jo më të shqetësoheshin për disa njerëz anonimë në Shqipëri. Por Mbreti Zog, as gjatë mbretërimit dhe as gjatë LDB, nuk e bëri kurrë këtë, sepse ishte dhe mbeti kundër vëllavrasjes.

Edhe spekulimi tjetër me togfjalëshin e përsëritur "pas të gjitha gjasave", kur autorët nxjerrin dhunshëm përfundimin askund të provuar se "Aleanca zogisto-komuniste u prish vërtet pas Mukjes, por, pas të gjitha gjasave, për faktin se komunistët në Konferencën e Dytë të Këshillit Nac-Çl. në Labinot, në korrik të vitit 1943, ku mori pjesë edhe Abaz Kupi, refuzuan të mbajnë premtimin për zgjedhjen e Zogut si kryetar të Frontit Antifashist Nac-Çl."

Me çfarë dokumentash e vërtetojnë autorët këtë "refuzim", aq më tepër që arkivat kanë qenë e janë të hapura për gjetjen dhe mbathjen e këtij "argumenti" të sajuar. Nëse do të ish e vërtetë kjo kërkesë (pra e Mbretit për kryetar të Frontit) dhe "refuzimi" për këtë shkak - Kupi ose rivalët ballistë do ta përdornin këtë fakt, sidomos këta të dytët, me të drejtën e dekonspirimit të lojës me dy porta të një formacioni nacionalist, ndërkohë që i kishin ngrënë dhe po vazhdonin t'i hanin thikat pas shpine nga komunistët, në atë fillim genocidi të përgjakshëm. Por kjo nuk ndodhi dhe nuk mund të ndodhë e të përdoret edhe sot e gjithë ditën, thjesht sepse është një hamendje e pabazuar, e cila vërteton edhe qëllimin diabolik të shtab-shkruesve. I vetmi "citim" i autorëve "mbështetur në bibliografi dhe dokumenta autentikë", është pasazhi i nxjerrë nga "kujtimet" e të verbërit Myslym Peza, i cili na qënkerka shndërruar në "Fuat Çelë", megjithëse nuk arriti të mësojë kurrë shkrim e këndim. "Argumenti" që paskërkan shkëputur autorët nga "kujtimet" Myslym Pezës, me synimin e vërtetimit të bashkëpunimit midis Kupit dhe Hoxhës, na qënkerka habia e "Dhelprës Plakë (Kupit)", kur paskërka parë yllin e kuq në xhakëtën e Myslym Pezës në fund të vitit 1943!!!

Po përse ta hanë mendjet normale këtë përrallë që nuk gënjen as fëmijët, në një kohë që Kupi i kish parë yjet e komunistëve që në Pezë. Madje ato ia kish parë edhe në Labinot, sikundër citojnë autorët më lart. Kupi nuk kish asnjë arsye për të bërë të habiturin për mbajtjen e yjeve nga komunistët, madje ky fakt nuk i shërbente atij për të justifikuar asgjë, pra aq më pak

“prishjen” me komunistët për këtë “arsye”.

Iluzionet e munguara dhe tradhtia

Mbreti dhe Kupi “nuk paguan çmimin e aleancës me komunistët” pas inkursionit të tyre në Veri, por paguan çmimin e tradhtisë vëllavrasëse sllavo-komuniste, dhe ky fakt nuk mund të vërtetohet fajësi dhe “penalizim” politik sot, porë në këndvështrimin e pacifizmit që karakterizonte Mbretin Zog dhe legalistët zogistë.

“Habia” e autorëve se përse Mbreti Zog nuk dekonspiroi dokumentat arkivorë për qënien e krerëve komunistë si “agjentë të tij”, e mori përgjigjen më lart. Ndërkohë që, me supozimin “Ndoshta Zogun e kanë ndaluar britanikët për ta bërë këtë gjë...”, artikullshkruesit vijnë hamendjet e tipit “ndoshta”, me të cilat spekulohet e nxirren përfundime të pambështetura në fakte.

Mashtimi si “argument” i politikës së ditës

Autorët gënjejnë kur, duke dashur të godasin e diskretitojnë Mbretin Leka për “flirt me komunistët”, përdorin e komentojnë mesazhin e Tij të përshëndetjes me rastin e 62 vjetorit të Konferencës së Pezës. Ata mashtrojnë kur shkruajnë se, në Pezë, “Enver Hoxha dhe Miladin Popoviçi ia punuan Ahmet Zogut”, duke aluduar hapur se Trashëgimtari i Tij, e gëlltiti “poshtërimin”. Po si ia punuan dhe çfarë poshtërimi i bënë Miladini dhe Enveri Ahmet Zogut në Pezë, kur dihet nga të gjithë se Kupi e përzuri si qen Popoviçin, duke e lënë të hungërijë e ulërijë, (pas derës së sallës së Konferencës), me sharje të ndyra në serbisht në adresë të Kupit dhe këlyshëve komunistë, që pranuan kushtin e Kupit “... se këtu nuk kanë punë serbët, përveç shqiptarëve, ndryshe largohem nga Konferenca”.

Dëshmitarët okularë citojnë Popoviçin të ketë thënë: “Këta maskarenj guxuan të më përzenë nga Konferenca mua, që jam kryetari i PKSH”. Po cilit ia punoi Hoxhë derëzui, kur rrinte në konferencë si qen i rrahur ngaqë nuk e pyste askush, sepse ligjin e bënin ata që u zgjedhën në krye pas përfundimit të saj, ndërkohë që Hoxha u zgjodh thjesht anëtar i Këshillit Antifashist Nac-Çl., nga 7 të tillë midis 17 pjesëmarrësve!!! Kujt ia punoi Enver Hoxha, kur i vetmi përfaqësues i PKSH me post të lartë në kryesi ishte miku i Kupit Mustafa Gjinishi, që u zgjodh sekretar, e që më pas u vra pas shpine nga Hoxha.

Asokohe, Hoxha dhe Miladini jo vetëm që nuk ia hodhën askujt, por nuk përfituan asgjë politikisht, (gjithmonë në raport me synimet e tyre të mbrapshta). Dhe kjo sepse kuintesenca e Rezolutës së miratuar nga Konferenca ishte “... bashkimi i të gjithë shqiptarëve pa dallim feje, krahine e ideje në luftën Antifashiste Nac-Çl, deri në çlirimin përfundimtar të vendit nga okupatori fashist...”.

Çfarë përfitimi mund të nxirrin Hoxha e Miladini nga lufta..., përveçse plumbat kokës, nëse nuk e ruanin atë?! Atëkohë, ata as që e mendonin se, ndonjë ditë, do ta merrnin e gëzonin, të vetëm, pushtetin. Hoxha i gJORë, atëkohë mendonte thjesht të futej në tavë nga ata që bënë ligjin në këtë vend, ngaqë as kunati i tij arrivist e profashist nuk arrinte të ulej në tryeza me “baballarët” e atëhershëm të Kombit, e jo më i biri i “Anesë së Sokakëve të të Marrëve”, të cilës i këndoheshin akoma këngë “patriotike” ngaqë kish kontribuar për të “vrrarë Bimbashin... /Hundëmadh e buzëtrashin...”, vargje të cilat qoftëlargu hundëmadh e buzëtrashë dha urdhër të zhbëheshin, pasi u bë i pari i vendit.

Ata që guxuan t’i këndonin këto vargje, ai i poqi të gjallë në zjarrin që skuqte kudhrën e diktaturës...

Artikullshkruesit proletarizojnë fisnikërinë

Më pas autorët kalojnë në fyerje të panevojshme, (që nxjerrin zbuluar porosinë për qëndisjen

e këtij shkrimi të mbushur me të pavërteta e spekulime), tek rreken t'i mbushin mendjen Mbretit Leka që të shpallë abdikimin, duke përrallisur se "... Leka Zogu i ka kufizuar kufijtë e mbretërisë së vet vetëm në pronat e kurorës, mbi të cilat ai ka një të drejtë trashëgimore të dyshimtë, pasi ato prona ai i ka poseduar me titullin e trashëgimitarit të shtetit shqiptar dhe jo si trashëgimtar i Xhemalit dhe Fatimes".

Lidhur me këtë paragraf, së pari duhet ritheksuar se Mbreti Leka as që ka ndërmend të shpallë abdikimin, aq të shumëpritur nga kuqot republikanë që gëlojnë në politikë...

Së dyti, e drejta e pronësisë është një e drejtë themelore e gjithkujt, madje është e dyta për nga renditja, pas të Drejtës së Jetës. Kjo e Drejtë është konsakruar në të gjitha kartat ndërkombëtare për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, ndërmjet të cilave spikat edhe ajo e OKB-së, e firmosur edhe nga Hoxha që në vitin 1951, kur Shqipëria u pranua anëtare me të drejta të plota në OKB.

Pas viteve '90-të, shteti shqiptar firmosi si palë dhe pranoi detyrimet për përmbushjen e shumë Kartave të tjera, që qëndronin në themel të marrëveshjeve për nënshkrimin e Kartës së Helsinkit, Parisit, Kopenhagenit..., deri tek marrëveshjet dhe konventat e panumërta, që e detyrojnë atë të njohë e kthejë pronat e pronarëve legjitimë.

Por nëse Mbreti Leka tregohet i durueshëm dhe i përkorë në këtë drejtim, nuk është se nuk ka të drejtë ligjore dhe morale, (sipas autorëve), apo sepse këto prona kanë burim origjine "të dyshimtë" dhe mund të jenë vënë me anë të abuzimit me pushtetin, ose përdorimit të tij për të përvehtësuar me ligj prona shtetërore, publike e private.

Para se të hidhnin këtë akuzë, autorët duhet të kontaktonin më parë me avokatët e ngarkuar me detyrën e nxjerrjes dhe vërtetimit me rrugë ligjore të pronësisë së Familjes Mbretërore, dhe kështu do të shihnin se dosja përkatëse është shumë e madhe. E vetmja pronë, dhuruar Mbretit Zog me vendim parlamenti, është një parcelë pyjore në Divjakë. Por arsyeja kryesore që shpjegon maturinë e Mbretit Leka në mosshpejtimin e procedurave për kthimin e pronësisë, është kujdesi i Tij për ta përfituar këtë të drejtë vetëm nëpërmjet ligjeve që rregullojnë problemin e pronësisë njëkohësisht edhe për qytetarët e tjerë. Dhe kjo jo sepse Ai nuk ka nevojë për to. Por sepse nuk është në moralin e Tij të pranojë diferencim privilegjues në krahasim me shtetasit e tjerë, dhe sepse nuk do të dëshironte që një privilegjim i mundshëm të përdorej politikisht nga njerëz të skotës së autorëve.

#### Ndërkombëtarët mbështesin monarkët

Me këtë rast jam i detyruar t'u kujtoj autorëve se institucionet më të larta euro-atlantike u kanë sugjeruar qeverive të vendeve ballkanike, (dikur ish-mbretërore), që menjëherë t'u kthenin familjeve mbretërore pronat e dikurshme dhe të drejtat civile të mohuara, madje t'u akordonin edhe privilegjet që u takojnë, me anë të ligjeve për trajtim të diferencuar në rang personalitetesh dhe, njëkohësisht, t'i inkorporonin ato në protokollin shtetëror.

Në Serbi, pasardhësit e Karagjorgjeviçëve e përfituan menjëherë këtë trajtim të veçantë dhe me përparësi, madje Karagjorgjeviçët u futën në protokollin më të lartë shtetëror. Për ilustrim do të referoja faktin se, kur në qershor 2002 përfaqësuesja e Unionit Serbi-Mali i Zi fitoi kupën e Botës në kampionatin botëror të basketbollit që u zhvilluan në SHBA, për të pritur basketbollistët kampionë në ceremoninë festive të organizuar në aeroportin e Beogradit, krahas presidentit Milutinoviç, kryeministrit Xhinxhiç dhe ministrit të Jashtëm Svilanoviç, ndodhej edhe trashëgimtar i kurorës Aleksandër Karagjorgjeviç, i cili në protokoll ishte i katërti, pas tre të parëve. Po kështu edhe Princi Nikolla (Knjazi) i Malit të Zi - me vendim të qeverisë dhe miratim të parlamentit u thirr menjëherë nga Parisi, (në periferi të të cilit kishte një studio modeste arkitekture), dhe me procedura të përshpejtuara ligjore atij iu kthyen të gjitha pronat, ndër të cilat shkëlqen Pallati i Bardhë madhështor në Cetinjë, (dikur ish Rezidencë Mbretërore). Po kështu u veprua edhe në Bullgari e Rumani.

Në Greqi, neokomunistët pasokistë, në delirin e pushtetit dhe me arrogancën karakteristike, jo vetëm që u sollën poshtërsisht me trashëgimtarin Jorgo të fronit mbretëror, por e kërcënuan atë me zhdukje fizike, teksa nuk e lejuan jahtin e tij të ankorohet në portin e Pireut, duke guxuar të përdornin kundër tij edhe silurues detarë "nëse nuk do të largohej me shpejtësi nga ujërat territoriale të Greqisë".

Po këtë gjë donin të bënin neokomunistët-pasokistë shqiptarë në pushtet, me anë të gjyqit qesharak dhe akuzave monstruoze kundër Mbretit Leka, pas incidentit të sajuar të 3 Korrikut të vitit 1997.

## Historia e një dinastie

Autorëve shpifarakë do t'u kujtoja se babai i Mbretit Zog vërtet quhej Xhemal, por Ai nuk ishte "Xhemal katunari" i komunizmit dhe neokomunizmit, as bir bariu, por ishte i famshmi Xhemal Pasha, i biri të madhit Xhelal Pasha, nip i Mahmut Pashës dhe stërnip i Ahmet Pashës - pinjollë të një dinastie pashallarësh të Matit, Dibrës e Krujës për afro 4 shekuj, me rezidencë në Matin me 7 kështjella, me dhjetëra kisha e xhami madhështore, deri edhe me shkolla fetare ku mësohej shqip.

Zogollët qeverisnin Matin edhe në kohën kur atje bëheshin kuvende për çlirimin e Shqipërisë nga pushtimi turk. Në kohën e sundimit të tyre, në kishën e madhe të Dukagjinit, në vitin 1602 u zhvillua Kuvendi i famshëm, në të cilin morën pjesë afro 4000 prijës nga i gjithë vendi, për të lidhur besën si në Kuvendin e Lezhës në vitin 1444 nën Skënderbeun, për luftë kundër pushtuesve turq.

Në vitet 20-30 të shekullit XVII, patrioti i madh, prifti dijetar Pjetër Budi hapi shkollën e parë shqipe, natyrisht fetare, dhe më pas edhe shkolla të tjera të shumta në të gjithë Matin. Ai gjithashtu nisi përkthimin në gjuhën shqipe të librave të shenjtë dhe meshoi shqip, gjë që i kushtoi edhe jetën. Dhe të gjitha këto me përkrahjen e drejtpërdrejtë të Zogollëve.

Autorët duhet ta mësojnë se një nga 7 kështjellat e Matit është edhe ajo e Zogollëve në Burgajet, quajtur nga populli Sarajet e Zogollëve. Kjo kështjellë ishte katër katëshe, me katin e poshtëm nën tokë, që shërbente si burg për shkelësit e ligjit, si hambar për ushqime, si depo armatimi e municioni dhe si garnizon ushtarak.

Gjatë shekullit XVIII në këtë kështjellë shkonin vazhdimisht për vizita konsujt e Anglisë, Francës, Greqisë, Serbisë dhe Rusisë. Kjo kështjellë madhështore ishte ndërtuar me gurë mermeri të kuq, në formë kubi me brinjë me përmasa 40 cm, që peshonin afro 120 kg. Pas LDB, për të fshirë nga faqja e dheut gjurmët e kësaj dinastie të famshme, komunistët i prishën Sarajet, por gurët e tyre u përdorën për ndërtimin e një kinemaje madhështore dhe me to u shtruan mijëra metra bordura të trotuarëve të qytetit të Burrelit. Gjurmët ruhen edhe sot, megjithë ndryshimet e ndodhura. Këtë gjë e dinë të gjithë matjanët dhe kushdo që e ka parë qytetin e Burrelit.

Autorët gjithashtu duhet ta mësojnë se Xhelal Pasha e kish nisur aktivitetin politik kundër Portës së Lartë që në vitet '40 të shekullit XVIII-të. Për këtë ai kontaktoi edhe me Carin e Rusisë, që e priti dhe e mbajti për 6 muaj në Ekaterinosllav. Porta e Lartë, për ta eliminuar fizikisht e emëroi guvernator të Anadollit, por ai e refuzoi këtë detyrë. Paskëtaj, për ta joshur që të mos rebelohej, e emëruan guvernator të Bosnje-Hercegovinës, ku përsëri vazhdoi veprimtarinë politike kundër Portës së Lartë. Për këtë arsye, në vitin 1958, ai zhvilloi takime të fshehta në Bernë të Zvicrës me konsujt anglezë, francezë e rusë, të cilëve u kërkoi financime dhe armatime për të filluar kryengritjen.

Por kur mësoi synimet e vërteta të serbëve të mbështetur nga rusët, ai i ndërpreu menjëherë bisedimet dhe refuzoi çdo bashkëpunim me Fuqitë e Mëdha, për t'u mbështetur paskëtaj vetëm tek shqiptarët e për të luftuar për Shqipërinë, sikundër bëri bashkë me të birin, Xhemal Pashën, në Prizren, në vitin 1878. Atje, Xhelal Pashë Zogolli, (gjyshi i Mbretit Zog), për

meritat e tij atdhetare, për fuqitë ushtarake dhe financat që derdhi në arkën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, u emërua zv/komandant i Përgjithshëm i saj.

Kur Ahmet Zogu 17 vjeçar, në krye të qindra matjanëve shkoi në Vlorë më 28 nëntor 1912 për të marrë pjesë në ngritjen e Flamurit, teksa u gjunjëzua ta puthte atë, Ismail Qemali e ngriti duke i thënë: "Ngrihu biri im. Këtu na sollën idealet dhe mësimet e gjyshit tënd, amanetin e të cilit po çojmë në vend sot...".

Shpifësit të ndërrojnë edhe emrin...

Babai i Mbretit Zog, Xhemal Pasha, në vitin 1880 u martua me zonjën Melek, martesë prej nga lindi, në vitin 1881, Princ Xhelal Zogu. Në vitin 1884, Xhemal Pasha u martua sërish, tashmë me pinjollen e shquar të Toptanajve, Nënë Mbretëreshë Sadije, prej nga lindi Mbreti Zog, në vitin 1895.

Nuk e di se nga e kanë gjetur autorët emrin Fatime. Kjo bëhet për fyerje, për të treguar se, po të duan, ata janë në gjendje të ndërrojnë edhe emrin e nënës. Dhe kështu ata nuk skuqen edhe kur bëjnë të paditurin sa të ngatërrojnë qëllimisht faktin se Mbretëresha e Shqiptarëve quhej Nëna Mbretëreshë Sadije, deri në fund të jetës, në vitin 1934.

Artikullshkruesit e dijnë mirë se Toptanasit e shquar kanë ende një kala në mes të Tiranës dhe prona të stërmëdha, nga të cilat shumë syresh i trashëgoi Nëna Mbretëreshë Sadije, e cila ishte vajza e vetme e njëres prej dyerve më të pasura të vendit dhe pinjolle e denjë e një dinastie princërisht, dukësh, kontësh e baronësh, fillesat e së cilës datojnë që në shekullin XIII-të. Por Zogollët, në linjë gjenetike janë pasardhës edhe të Kastriotëve, e vërtetuar kjo edhe me pemën gjenealogjike të nxjerrë nga arkivat.

Janë pikërisht këto lidhje gjenetike me dinastitë më të shquara e më të mëdha, ato që determinuan kurorëzimin e "Nip-stërnip-it të Skënderbeut" nga Asambleja Kombëtare "Mbret i Shqiptarëve", më 1 Shtator 1928.

Pa dashur t'i fyej, sepse as këtë nuk e meritojnë, ligësisë së tyre autorët i shtojnë edhe injorancën e skajshme, teksa harrojnë se ajo nuk përbën argument, aq më tepër në publicistikën historike.

LZHK nuk është e nuk mund të jetë DBSH

Pa qenë nevoja të komentoj arsyet e krijimit, qëllimet dhe objektivat politikë të së Djathtës së Bashkuar, e kam të qartë përjashtjen e rolit të DBSH të dikurshme me LZHK e sotme, të cilën autorët duan ta përdorin si trampolinë për të kërcyer tek ideja se "LZHK përçan dhe diskrediton të djathtën ashtu sikundër bëri dikur DBSH". Pra paralelja është e qartë. Ata duan ta akuzojnë Mbretin Leka si përçarës të së djathtës, duke e titulluar shkrimin e tyre "Forca e tretë (LZHK) - Kolonë e pestë", e duke operuar me supozimin se "Leka Zogu po hyn në politikë para se t'i kthehen pronat, çka nuk mundet të mos krijojë dyshimin se lëvizjet politike të tij do të kushtëzohen nga qëllimi i vet imperativ për kthimin e pronave, çka do ta çojë atë në pazare me kryeministrin Nano (!!!)".

Autorët sërish duhet ta kenë të qartë se Mbreti Leka nuk po hyn në politikë, por ka qenë dhe do të mbetet gjithmonë në politikë, si Mbret dhe politikan profesionist. Vetë realiteti i dhimbshëm shqiptar në të gjithë hapësirën shqiptare në Ballkan, është një shtysë për Mbretin për t'u marrë me politikë, si e vetmja mënyrë për ndryshimin e kësaj gjendjeje. Ai dhe pasuesit e Tij nuk njohin ndonjë instrument dhe nuk dinë ndonjë mënyrë tjetër për realizimin e ndryshimeve të domosdoshme në hapësirën mbarëshqiptare, përveçse politikës. Por autorët mendojnë se kanë tagrin edhe t'ia heqin Mbretit të drejtën për t'u marrë me politikë dhe për t'u pozicionuar sipas dëshirës, ndryshe e akuzojnë për "pazare me Nanon", pra mund ta etiketojnë e njollosin si të duan.

Autorët mashtrojnë paturpësisht kur shkruajnë se "familja Zogu nuk ka asnjë lidhje gjaku me familjet dinastike europiane", ndërkohë që një gjë e tillë është e provuar dhe dihet nga të gjithë. Këto prova po shtohen çdo ditë e më tepër, madje edhe me presidentë dhe kandidatë për presidentë të SHBA-ve.

### Prognozë politike me shifra të falsifikuara

Edhe shifrat elektorale, të servitura nga këta shtabistë, janë cituar e përdorur me gabime të qëllimshme, madje ata kanë guxuar të "vërtetojnë" pa fakte se cilët "opozitarë" votuan pro Referendumit të 29 Qershorit të vitit 1997. Për t'i nxjerrë të sakta "hesapet" e tyre dhe bashkë me to edhe prognozën e rezultatit të pritshëm të LZHK në zgjedhjet e ardhshme parlamentare, ata po përdorin rezultatin e PLL në zgjedhjet vendore të 12 tetorit 2003, gjë që është marrëzi e padëgjuar, kur tenton të bësh prognoza zgjedhore të mbathura me shifra të viteve të kaluara. Ata sërish shpifin kur nxjerrin me megallomani konkluzionin se "Sot Leka Zogu nuk mund të jetë i sigurt as për këtë shifër (2.31 % të PLL), pasi edhe këta zgjedhës e kanë braktisur kur e panë ... Leka Zogun që po bashkëpunon qartas me Fatos Nanon (!!!)", ndërkohë që nuk na e tregojnë se ku e shohin këtë bashkëpunim!

### Republikanizmi i "fyer"

Autorët duan të ngjallin urrejtje për Mbretin Leka kur interpretojnë deklaratën e Tij, se "nuk do të kandidoj për deputet në zgjedhjet e ardhshme". Ata aludojnë haptas se kjo është "një përçmim për institucionet e zgjedhura republikane (!!!)".

Ata bëjnë sikur nuk e kuptojnë se Mbreti nuk ka abdikuar dhe nuk pranon të abdikojë nga Froni i ligjshëm i një trashëgimtari të ligjshëm, e drejta e mbretërimit të të cilit është mohuar me dhunë nga kriminelët fashistë, bolshevikë dhe sllavo-komunistët më gjakatarë që polli toka shqiptare. Mbreti po i respekton institucionet republikane aktuale dhe ligjet në fuqi. Madje edhe vetë autorët nuk po mundën të përmendin ndonjë delikt dhe fyerje të institucioneve, shkaktuar prej Tij.

Përdorimi i shembujve dhe zhvillimeve në Bullgari, dhe përjasjet e qëllimta me Mbretin Simeon II, nga autorët bëhet për të nxjerrë konkluzionin e "dështimit" të paralajmëruar të Mbretit Leka dhe LZHK, dhe ky është një alogjizëm idiotesk, që nuk mund ta pranojnë as fëmijët.

Me "logjikë" bagëtish, autorët përqasin cilësitë e larta dhe meritat e Mbretit Simeon, dhe kujtojnë se me këtë vërtetohet "mungesa" e tyre tek Mbreti Leka, për të cilin nuk kanë kurrfarë njohjeje të drejtpërdrejtë - dhe këtë marri, ata pretendojnë ta shesin për arsyetim analitik. Kjo është si të rrekesh të bësh Regjistrin kombëtar zgjedhor në Shqipëri duke numëruar kinezët, apo të shpjegosh rritjen demografike të Indisë duke iu referuar eskimezëve të Groenlandës!

### Paniku për "kolonën e dështuar"

Më poshtë autorët fyejnë sërish me "oborrin gjysmoriental", duke ngatërruar qëllimisht emrin e një xhelati të Sigurimit të Shtetit (afro 80 vjeçar) me studiuesin dhe njëkohësisht Doktor i Shkencave Ushtarake, zotëri Sulejman Abazit. Lidhur me zotëri Fluturak Gërmenjin, duhet theksuar se u shkarkua nga ministri i Mbrojtjes Safet Zhulali, në vitin 1994, kur shkoi në Johannesburg në përbërje të delegacionit që atëkohë vizitoi Mbretin Leka, pas ngjarjes së shëmtuar të 20 nëntorit të vitit 1993. Përsa i përket zotëri Baletës, autorët shpifin kur i atribuojnë role të rreme, sikur gjoja ai i bën fjalimet Mbretit Leka. Por edhe nëse do të ishte kështu, bashkëpunimi me një diplomat, politolog, publicist dhe atdhetar si Baleta, do të ishte nder dhe jo turp.

Ndërsa angazhimi i zotëri Eduard Ypit, këtij stërnipi të Frashërllinjve të mëdhenj, nip i Shahin bej Kolonjës (Ypit) dhe Abdyl bej Ypit, (ish ministër i Jashtëm i Mbretërisë), është i mirëpritur dhe i vlerësuar nga të gjithë nacionalistët. Vetë përbërja e Oborrit është në frymën e gjithpërfshirjes dhe angazhimit të të gjithë shqiptarëve që duan ndryshime thelbësore dhe zhvillim kombëtar, pa dallime krahinore e partiake.

Më poshtë, me një kërcim majmunësh, brënda të njejtës fjali autorët dalin me konkluzionin "magjik" se Mbreti Leka "... nuk ka një vizion për të ardhmen e vendit dhe as iluzionin më të vogël se mund të fitojë" - duke i prirë këtij "konkluzioni" me bindjen e deklaruar që në nëntitull se "Leka Zogu nuk shqetësohet nga dështimi". Po për çfarë "kolone të pestë" shkruajnë këta hajvanë, kur kanë bindjen se ajo do të "dështojë". E kujt i lipset një "kolonë" e dështuar që pa filluar zgjedhjet?! Aq budalla ta pandehin këta kaqolë Nanon!!! Po të ish kaq budalla Nano, nuk do t'i linte këta debilë "opozitarë" duke i qarë hallet Mbretit për "dështimin", tek baresin si bagëti 'anës Elbës, anës Spreesë-Lanës së Tiranës, që prej 7 vjetësh e kusur.

Më pas autorët trillojnë paturpësisht kur aludojnë për "një ish-kryebashkiak të kohës së PD", që do t'u bëka "deputet liste i LZHK si kompensim qiraje..."

Pastaj, me thashethemin e tipit "thuhet...", ata përpiqen të fabrikojnë "detyrime financiare të pashlyera të Mbretit në Angli".

Ata sërish gënjejnë kur shkruajnë se "ZP" nuk po e sulmon Mbretin, në një kohë që taborret e enveristëve, të hapur e të fshehtë, po përdorin shumë media për shpifje ndaj Mbretit dhe LZHK. Edhe "ZP" ka botuar dhjetëra sulme të tilla, por ajo tani ka edhe halle të tjera përderisa nuk po prodhon përditë "simite" enveriste, po e ka përcjellë stafetën...

Edhe konkluzioni se "Leka Zogu ka nevojë për kura të shtrenjta...", është një shpikje tjetër e artikullshkruesve mendjengushtë, të cilët me anë të fjalëkalimit "me sa duket", dalin në faqen pasardhëse të fajllit të shpifjeve, për të vërtetuar "financimin" e Mbretit dhe LZHK nga Nano. Jua garantoj, është më mirë se unë me shëndet.

Autorët sërish shpikin kur sajojnë se PS do t'i lërë LZHK-së zona të lira "në Mat, apo në krahina të tjera ku nuk ka shpresë për fitore...", apo kur me anë të fantazisë në adresën "Celibashi-Subashi", sajojnë skemën e "rritjes së rezultatit të LZHK në kurriz të rezultatit të LSI".

Meqenëse ata përmendën LSI, të cilës indirekt ia pranojnë fuqinë elektorale, duke i qarë njëkohëshit hallin se do "martirizohet" nga "Celibashi-Subashi" në altarin e Nanos dhe LZHK, atëherë ata gabohen në përcaktimin "Forcë e tretë" në adresë të LZHK, sepse, sipas tyre na dalin katër Forca - prej nga del se ata ia kanë këputur kot që në titullin e madh të artikull-shpifnjës "LZHK - Forcë e tretë..."

LZHK nuk ka dalë në arenën politike as për të bërë forcën e tretë dhe as për të ndikuar shifrat e pjesëmarrësve që e ndiejnë se mund të konkurrojnë në politikën shqiptare.

Afër fundit të këtij shkrimi plot shpifje dhe hamendje të përçartura, autorët, për të vërtetuar "dështimin" e Mbretit Leka dhe LZHK, dhe duke dashur të ndikojnë tek zgjedhësit, lëshojnë "profecinë" se "Në të vërtetë këta njerëz nuk do të votojnë për një alternativë reale por për një iluzion dhe për më tepër për një iluzion që nuk e ka as njeriu për të cilin ata po votojnë."

LZHK ka programin dhe vokacionin e vet politik, dhe pret të marrë votat e përkrahësve të saj, të cilat nuk mund të përcaktohen nga orakujt dhe alkimistët e politikës dhe publicistikës, kushdo qofshin dhe pavarësisht nga ndikimi në elektorat dhe media. Ky është thelbi dhe qëllimi i pluralizmit.

Pasi ngrejnë një kështjellë rëre, të cilën truderra të tillë nuk mund ta ngrinin përveçse duke punuar për muaj të tërë - ata na servirin gjepurën e radhës se "vota për LZHK do të thotë votë për Familjen Zogu..., që të zgjidhë problemet e veta ekonomike" dhe votë "për disa vende në parlament...". Me këtë pohim ata hedhin në hale teorinë konspirative të "kolonës së pestë", ideuar nga "Nano-Leka Zogu", duke rënë brenda edhe vetë.

Supozimi i autorëve se "edhe sikur të ishte gjallë Ahmet Zogu dhe të vinte në krye të LZHK..., ajo do të dështonte", meriton këtë përgjigje: nëse do të ishte gjallë Ahmet Zogu, ky vend do të dekomunistizohej realisht dhe përfundimisht. Sa ishte Ai President e Mbret, kryengritjet subversive antikushtetuese shkriheshin si kripa në ujë dhe komitarët e rebelimeve, bashkë me central-komitarët e PPSH, jo vetëm që nuk do të bënin ligjin, por do futeshin skutave nga frika e litarit dhe e ndëshkimit për tradhtinë.

Replikë e detyruar dhe arsyet

Në përfundim të këtij shkrimi, më bie ndërmend dëshpërimi i Faik bej Konicës për "kovat e m..." që iu desh të mbante duke denjuar t'i kthejë përgjigje një shkarrashkrimi grupautorësh. Ç'të bësh tjetër kur, nga halli dhe nevoja për t'i ndihur të vërtetës, merresh me të njëjtin takëm njerëzish, (sikundër Faik beu, njëherë e një kohë), të cilët, nga fillimi e deri në fund të shpifnajës së tyre "publicistike", nxjerrin konkluzione mbi supozime, mbi hamendësime e trillime, mbi gjysëm të vërteta dhe engrama të prodhuara nga koka të sëmura. Shkrimi i këtyre shtabistëve ishte i mbushur me alogjizma dhe lidhje të shkurtra midis njerëzish, ngjarjesh e fenomenesh krejt të shkëputura. Pasazhet më të neveritshme të tij ishin fyerjet e pamerituara në adresë të Mbretit Leka dhe Familjes Mbretërore, shprehje këto të një urrejtjeje patologjike, pasojë e një çrregullimi të pakthyesëm psiko-mental. Por arsyeja kryesore që më shtyu të përgjigjem me anë të kësaj replike, ishte dëshira për të shmangur spekulimet trashanike dhe akuzat e pabazuara, bashkë me synimin për t'i shërbyer gjithmonë të vërtetës, për të cilën sot, më shumë se kurrë, kanë nevojë shqiptarët.

Botuar tek tema